



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VII  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-024  
Prishtinë, më 5 tetor 2020, në orën 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 TETOR 2020**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit; Arbërie Nagavci, Kujtim Shala dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Rexhep Selimi, Arben Gashi, Bedri Hamza dhe Teuta Haxhiu.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetares së Kuvendit:** Faton Peci dhe Artan Murati.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Shefki Shoshaj.

**Nga: KDI-ja:** Agnesa Haxhiu.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

#### Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 7, 13, 14 gusht dhe 17, 18, 21, 25 e 28 shtator 2020,
3. Përgatitjet për seancën e re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

\* \* \*

Në fillim, kryetarja i njoftoi të pranishmit se Komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, z. Oliver Varheli, do ta vizitojë Kosovën, të enjten, më 8 tetor 2020, dhe me këtë rast, ndër të tjera, do t'i adresohet me një fjalë rasti edhe Kuvendit të Kosovës në seancë plenare.

Po ashtu, kryetarja njoftoi se po atë ditë është paraparë edhe një vizitë nga Gjermania, por pritet ndërkohë të konfirmohet vizita e tyre.

\* \* \*

Pastaj, kryetarja procedoi me pikat e rendit të ditës:

### **1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14 dhe 22 shtator 2020.

### **2. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 7, 13, 14 gusht dhe 17, 18, 21, 25 e 28 shtator 2020**

### **3. Përgatitjet për seancën e re plenare**

Kryesia i shqyrtoi së bashku pikat 2 dhe 3 të lartshënuara të rendit të ditës dhe pas diskutimeve, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë javës t'i mbajë tri (3) seanca plenare, si vijon:

***I. Vazhdimi i seancave plenare do të mbahet të enjten, më 8 tetor 2020, në orën 10:00, me këtë:***

Rend dite

***I. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 7, 13, 14 gusht dhe 17, 18, 21, 25 e 28 shtator 2020:***

1. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,
2. Votimi në parim i Projektligjit nr.07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike - COVID-19,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi,
4. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, e nënshkruar edhe nga 9 deputetë tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me hyrjen dhe patrullimin e pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës,
5. Votimi në parim i Projektligjit për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë COVID-19.

***II. Seanca e re plenare e radhës do të mbahet po ashtu të enjten, më 8 tetor 2020, në orën 11:30, me këtë:***

Rend dite

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-031 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2019, Pjesa e dytë Objektiv 1, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-034 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për transferimin e personave të dënuar,
5. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-018 për ndryshim plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.07/L-015 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2019,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2019,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2019,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2019.

**III. Seanca tjetër plenare e radhës do të mbahet të premten, më 9 tetor 2020, në orën 11:00, me këtë:**

Rend dite

1. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Avdullah Hoti, për punën 100-ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

#### **4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave**

*1. Kërkesa e Komisionit për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media për t'i kërkuar Qeverisë së Republikës së Kosovës të fillojë përgatitjen për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Rasti KO203/19*

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të hartojë projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Rasti KO203/19.

2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë të procedohet nga Qeveria në Kuvend së bashku me projektligjin për pagat.

*2. Kërkesa e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për lejimin e shpenzimeve shtesë*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **V E N D I M**

Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë (7) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të formuar nga Kuvendi i Kosovës, me vendimin nr. 07-V-024, datë 10. 7. 2020 i lejohen mjete financiare shtesë në shumën prej 300,00 (treqind) euro.

### *3. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këtij Këshilli është ndihmuar nga ekspertët sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Ambasadës Britanike.

Ajo tha se disa kandidatë për anëtarë të këtij Këshilli nuk janë vlerësuar njëjtë nga Komisioni ad hoc i Kuvendit me ata të ekspertëve nga mbështetja e Ambasadës Britanike.

Diskutimi i plotë i kryetares është i dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e zgjedhjes së pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, diskutuan: Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së; nënkryetarja Arbërie Nagavci; Bedri Hamza, në emër të GP të PDK-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; nënkryetari Kujtim Shala dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetarja tha se në lidhje me këtë çështje do të takohet me Komisionin ad hoc për të diskutuar rreth mundësive për plotësim të rekomandimit të Komisionit ad hoc.

Po ashtu, në lidhje me zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryetarja konstatoi se kurdo që të renditet në seancë plenare, zgjedhja e tyre do të bëhet me dy kategori, për të siguruar përfaqësimin gjinor në përputhje me ligjin.

#### **Të ndryshme:**

1. Kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu kërkoi nga grupet parlamentare që nëse ka deputetë të interesuar për Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm t'i dërgojnë propozimet në këtë Këshill.

2. Kryetarja e shtroi çështjen e akomodimit të deputetëve me zyra në Kuvendin e Kosovës dhe kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, që të përgatitet një regjistër i zyrave dhe më pas t'i paraqitet Kryesisë së Kuvendit.

Diskutimi i plotë i kryetares është dhënë në transkript.

3. Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci, e shtroi çështjen e Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili është pa kryetar që nga data 26 nëntor 2019.

Diskutimi i plotë i nënkryetares Nagavci është dhënë në transkript.

Kryetarja Vjosa Osmani-Sadriu, në lidhje me çështjen e shtruar nga nënkryetarja znj. Nagavci, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se i është kërkuar Qeverisë së Kosovës që t'i shpallë konkurset publike për bordet e ndryshme të cilat i propozohen Kuvendit për zgjedhje apo emërim.

Ndërsa, në lidhje me Bordin e Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ajo tha se nëse është nevoja do t'i kërkojë edhe një herë Qeverisë që sa më parë t'i procedojë propozimet në Kuvend.

Diskutimi i plotë i kryetares është i dhënë në transkript.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:08 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

---

Kryetare e Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*